



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 12 dhjetor 2025

Nga: Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së

Për: Z. Shaban Neziri U.D, Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT Sh.A

Z. Alpin Dogan, Kryeshef Ekzekutiv KEDS SH.A

Z. Serhat Dinç, Kryeshef Ekzekutiv, KESCO SH.A

Kopje: Znj. Artane Rizvanolli, Ministre në detyrë e Ekonomisë

Z. Arben Loshi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit

Z. Gramos Hashani, u.d. Kryeshef Ekzekutiv i Korporatës Energjetike të Kosovës

Znj. Fëllënëza Xhelili Fiqi, Drejtoreshë për Çështje Ligjore dhe Rregullative, KOSTT Sh.A

Z. Kujtim Hoxha, Drejtor për Tarifa dhe Rregullativë

Znj. Rudina Heroi-Puka, Drejtoreshë e Departamentit për Shërbim ndaj Konsumatorit, Tarifa dhe Çështje Rregullative, KESCO Sh.A


Lënda: Azhurnimet vjetore të të hyrave dhe tarifave për OST/OT, OSSH dhe FSHU

Po ju drejtohem me qëllim të prezantimit të planeve të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) përkitazi me azhurnimin dhe përcaktimin e të hyrave të lejuara dhe tarifave të energjisë elektrike, të cilat pritet të hyjnë në fuqi më 1 prill 2026, të përcaktuara në Rregullat e të Hyrave të të Licencuarve.

ZRRE synon që të sigurojë që të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të jenë në përputhje me kostot reale dhe me parashikimet për periudhën tarifore. Në pajtim me rregullat e të hyrave, këto parashikime duhen azhurnuar për të marrë parasysh dallimet që ndodhin ndërmjet vlerave të parashikuara ndaj atyre të realizuara. Këto përshtatje barten në vitin vijues, përkatësisht ndryshimet e vitit t-1 barten në vitin t (t-1 paraqet vitin paraprak, t paraqet vitin relevant tarifor) në kuadër të procesit relevant tarifor. Pas mbledhjes së të dhënave relevante nga të licencuarit, ZRRE do të analizoj aplikacionet e të licencuarve për të përcaktuar kostot reale që reflektohen në to.

Ashtu siç është e përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE ka mandat të përcaktojë të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifat për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesin me Shërbim Universal. Tarifat e energjisë elektrike me pakicë për Furnizuesin me Shërbim Universal përcaktohen vetëm për konsumatorët që e gëzojnë të drejtën e shërbimit universal. ZRRE konform vendimit të Gjykatës Supreme dhe zbatimit të Ligjit për Energjinë Elektrike në frymën e Direktivës 2009/72/EC të interpretuar edhe nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit, thekson se konsumatorët të cilët e gëzojnë të drejtën e shërbimit universal janë konsumatorët të cilët në mënyrë kumulative i plotësojnë të dy kriteret e shërbimit universal, e ku përfshihen të gjithë konsumatorët familjarë dhe, kur e shohin të përshtatshme, ndërmarrjet e vogla (ndërmarrje me më pak se 50 punonjës dhe një qarkullim vjetor ose bilanc jo më shumë se 10 milion EUR).

ZRRE kërkon nga FSHU që në kuadër të përgatitjes së aplikimeve tarifore dhe dokumenteve përcjellëse, ka obligim që të marrë në konsideratë këtë vlerësim të ZRRE-së, së bashku me interpretimin detyrues të





Gjykatës Supreme, si bazë për zbatimin korrekt dhe të plotë të kriterëve kumulative për shërbimin universal. Në vijim të këtij vlerësimi, kërkohet që FSHU të reflektojë në aplikimet e ardhshme tarifore këtë interpretim të Gjykatës Supreme, në përputhje me kërkesat ligjore dhe me standardet e zbatimit të shërbimit universal.

Për qëllime transparence, ZRRE do të publikojë në tërësi aplikacionet e të licencuarve, krahas vlerësimeve përkatëse. Të licencuarit duhet të identifikojnë çdo pjesë që konsiderohet si konfidenciale.

ZRRE do të publikojë aplikacionet sapo të vlerësohen si të kompletuara dhe siguron palët e interesit që vendimet përfundimtare do të marrin parasysh të dhënat relevante dhe komentet e tyre. Përcaktimi i të hyrave për Furnizuesin me Obligim të Shërbimit Universal (FSHU) bëhet në baza vjetore, ndërsa tarifat për vitin relevant tarifar 2026 do të marrin parasysh përshtatjet e kostove të vitit 2025.

Në shtojcë është i përshkruar orari indikativ i procesit të përshtatjeve të rregullta dhe aplikimeve tarifore.

Me respekt,

Ymer Fejzullahu

Kryesues i Bordit të ZRRE-së





Shtojcë: Orari indikativ

Procesi i **përshtatjeve** të të hyrave për të licencuarit e OST/OT dhe OSSH do të kryhet duke u bazuar në Rregullat për të Hyrat e OST/OT dhe OSSH-së, përkatësisht sipas Shtojcës 7.

Orari indikativ:

OST/OT dhe OSSH deri më 23 janar 2026 do të ofrojë të dhënat si më poshtë:

- Përshtatjet e kostove të humbjeve;
- Përshtatjet për OPEX;
- Përshtatjet për kostot e bartshme;
- Përshtatjet për faktorin korigjues të të hyrave; dhe
- Përshtatje tjera të definuara në Rregullat e të Hyrave të OST/OT dhe OSSH-së.

Të licencuarit duhet të dërgojnë të dhënat në bazë të formateve të aplikuara nga ZRRE për shqyrtime tarifore.

Rregullatori do ta njoftojë OST/OT-në dhe OSSH-në 40 dite pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant lidhur me vlerësimin e tij për OST/OT-në dhe OSSH, përkatësisht më datë 13 shkurt 2026. Pas vlerësimit përfundimtar lidhur me përshtatjet e vitit 2025 dhe përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2026, OST/OT dhe OSSH duhet që deri më datën 10 mars 2026 të dorëzojnë propozimet për tarifa për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit, Operimit të Sistemit dhe Operimit të Tregut dhe tarifat Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (Tarifa SHSSH).

Procesi për FSHU-në

Procesi i **aplikimit** për të hyra të lejuara maksimale dhe përshtatje për FSHU-në është i ndarë në tri faza sipas Shtojcës 3 të Rregullës për të Hyrat e Furnizuesit me Shërbim Universal.

FSHU deri më 23 janar 2026 do t'i paraqesë Rregullatori të dhënat për kostot aktuale dhe parashikimet si më poshtë:

- Kostot e blerjes së energjisë elektrike;
- Kostot me pakicë;
- Kostot e bartshme të rrjetit transmetimit dhe shpërndarjes;
- Propozimi për të hyra për FSHU.

Rregullatori do ta njoftojë FSHU-në 40 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant lidhur me vlerësimin e tij, përkatësisht më datë 13 shkurt 2026.

Pas vlerësimit përfundimtar lidhur me përshtatjet e vitit 2025 dhe vlerësimit të të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2026, FSHU duhet që deri më datën 10 mars 2026 të dorëzojë propozimet për tarifa me pakicë për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal.

Bilanci i energjisë elektrike, si ai i realizuar ashtu edhe ai i parashikuar, duhet të jetë pjesë përbërëse e aplikacioneve të të licencuarve. ZRRE i inkurajon të gjithë të Licencuarit të harmonizojnë të dhënat e tyre për të shmangur devijimet në raportimet përkatëse.